

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, anëtarëve të trupit gjykues gjykatësve Emine Salihu dhe Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve S. S, nga fshati G. Komuna e V, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat ....nga Gj, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, A. T, nga fshati G Komuna e V, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat ...nga Gj, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2. të KPRK-ës, Z. Ki, nga fshati S. K. e S, të cilin me autorizim e mbron avokat..., nga Gj, për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. nën par.1.1. të KPRK-ës, B. K, nga fshati S Komuna e S, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat..., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe P. A nga fshati P Komuna e D të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat..., nga Gj për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti për Krime të Rënda PP.I. nr. 92/2015, të datës 23.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 19.04.2017, dhe në prezence të palëve publikisht shpalli me datë 21.04.2017 këtë :

## A K T G J Y K I M

### **Të akuzuarit:**

**S.S** nga i ati D dhe nëna M, e lindur S, i lindur me datë, në f. G Komuna e Vi, ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punësuar – pensionist, ka të kryer shkollën e mesme të bujqësisë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

**Z.K**, nga i ati A dhe nëna F, e lindur L, i lindur me datë 30.10.1986, në S Komuna e S, ku edhe jeton, i martuar, baba i një fëmije, i punësuar në një bastore në S ,, student i fakultetit ekonomik në kolegjin “Fama” në Prishtinë i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

**Besart Kokollari**, nga i ati Ali dhe nëna Fahrje, e lindur Lushaj, i lindur me datë 14.03.1990, në Stavrovë Komuna e Suharekës, ku edhe jeton, i martuar, i punësuar në një bastore sportive në Suharekë “Superbast”, ka të kryer fakultetin e kriminalistikës në kolegjin “Fama” në Prishtinë i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

## **JANË FAJTOR**

### **I.**

#### **I akuzuari Sefë Sylejmani,**

Se në kohë të pa vërtetuar me parë në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët, e ka sigurua dhe mbajte në pronësi armën të zjarrtë edhe atë një armë automatike me numër serik 680138, të cilën edhe e ka mbajte në kazinon “Merkur” në Viti, e që edhe më datë 18.05.2015, e njëjta armë është sekuestruar nga Policia e Kosovës Stacioni Policor në Viti.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

### **II.**

#### **I akuzuari Zekë Kokollari.**

Me datë 18.05.2015, rrethë orës 02,00 pas mesnate në kazinon “Merkur” në Viti pas incidentit që ka pasur me të pandehurin Alban Tahiri, në mënyrë të paautorizuar e në kundërshtim me ligjin për armët ka mbajte në posedim armë të zjarrtë edhe atë pushkën automatike me nr. serik 680138, e të cilën edhe e ka rrëmbyer nga i pandehuri Alban Tahiri, dhe ikë me automjetin e markës “Fiesta” dhe dëshmitarin Dibran Hasani, fillimisht në drejtim të fshatit Debellde e më pastaj me rastin e ndaljes dhe kontrollimit nga ana e pjesëtarëve të policisë së Kosovës Stacioni Policor në Viti, kapet dhe arrestohet dhe arma në fjalë i konfiskohet.

Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

### III.

Në kohën dhe vendin si në pikën I dhe II të aktgjykimit, ka lënduar lehtë të akuzuarin A. T nga fshati G, pasi që së bashku me të akuzuarit B.K dhe P. A, kanë shkuar për të kërkuar një borxh nga A. S në lartësi 1150 euro, dhe gjatë kacafytjes me të akuzuarin A, i akuzuari Z, e ka goditur me një mjet të fortë në kokë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, për çka dërgohet në Shtëpinë e Shëndetit në Viti e më pastaj në Spitalin Rajonal të Gjilanit, për trajtim mjekësor.

Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. nën par.1.1. të KPRK-ës.

### IV.

#### **I akuzuari B.K.**

Në kohën dhe vendin si në pikën II,III dhe IV të dispozitivit të aktakuzës gjatë kacafytjes me të pandehurin A.T, me dashje kanë sulmuar fizikisht të njëjtin duke e goditë me grushte e shqelma në pjesë të ndryshme të trupit përderisa i pandehuri Z.e ka goditur me mjetë të fortë në kokë dhe ikin në drejtim të fshatit D, ku edhe më pastaj ndalen dhe arrestohen nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në V.

Me çka kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41,46, 47, 51, 69, 73, 83, 114 dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, dhe neneve 365, 453, të KPPRK-ës.

## I G J Y K O N

**Të akuzuarin S. S,** për veprën penale sikurse në dispozitivin I të aktgjykimit me dënim me gjobë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin gjobë i akuzuari do ta paguaj 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

**Të akuzuarin Z. K.** për vepren sikurse në dispozitivin II. me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind euro) dhe për veprën penale sikurse në dispozitivin III me dënim burgu prej 2.(dy) muajve burgim, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.05.2015 e deri me datë 08.06.2015 ashtu që pjesa e mbetur e dënimit me burgim prej 39

*ditësh i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro e me zbatimin e dispozitave për dënimin unik për te dy veprat i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1.200 euro, të cilin gjobë i akuzuari do ta paguaj 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.*

*Të akuzuarit Z. K. i shqiptohet edhe dënim plotësues konfiskimi i armës të zjarrtë edhe atë pushkën automatike me nr. serik 680138.*

***Të akuzuarin B. K.***, për veprën penale nën dispozitivin IV të aktgjykimit. me dënim me gjobë prej 400 (katërqind) euro të cilin gjobë i akuzuari do ta paguaj 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

*Obliqohen të akuzuarit që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, për secilin veç e veç, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

## **V.**

### **Bazuar në nenin 364 par.1. pika 1.3. të KPPRK-ës**

*I akuzuari A.T nga i ati S, dhe nëna M, e lindur S, i lindur me datë ..., në V, tani jeton në f. G. Komuna e V. i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.*

## **LIROHET NGA AKUZA**

*Me datë 18.05.2015 rreth orës 01,00 h, në V, në kazino "" në V e ka marrë nga banaku automatikun me nr. serik .. pronë e S. S, dhe gjatë një grindje dhe mosmarrëveshje me Z. K, P. A e B. K, gjatë kacafytjes e ka përdorë në mënyrë kërcënuese dhe frikësuar duke i kërcënuar se do ti vras e që edhe i pandehuri Z. K. arrin të ia nxjerrë armën nga dora dhe më pastaj arma në fjalë i sekuestruar nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në V*

*Me çka kishte me kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2. të KPRK-ës.*

*Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.*

## **Arsyetim**

*Prokuroria Themelore në Gjilan,- Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr. 92/2015, të datës 23.06.2015, kundër të akuzuarve S. S, nga fshati G për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, A. T, nga fshati G Komuna e V, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2. të KPRK-ës, Z. Ki, nga fshati S Komuna e S, për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. nën par.1.1. të KPRK-ës, B.K, nga fshati S. Komuna e S dhe P. A nga fshati P.Komuna e D, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.*

*Gjykata ka veçuar procedurën kundër të pandehurit P. A, për shkak që i njëjti ka qenë i pa arritshëm për Gjykatën, për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurë dhe mbështetur në nenin 36 të KPPRK-së.*

*I akuzuari S. S, pas leximit të aktit akuzues nga prokurori i shtetit në mënyrë të plotë dhe bindëse e pranoi fajësinë për veprën e kryer penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, të cilën ja vë në barrë akti akuzues.*

*Po ashtu edhe I akuzuari B.K.e pas leximit të aktakuzës për veprën penale e cila i vihet në barrë sulmi nga neni 187 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës e ka pranua fajësinë në mënyrë bindëse dhe pa mëdyshje.*

*I akuzuari Z. K. ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, me datë 17.10.2016, për veprat penale të cilat i vihen në barrë edhe atë mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. nën par.1.1. të KPRK-ës, të cilën marrëveshje Gjykata në seancën e datë 19.10.2017 e ka aprovuar si kundër ka aprovuar edhe pranimin e fajësisë të bërë nga të akuzuarit S. S dhe B. K, derisa pasi që i akuzuari A.T. nuk e ka pranuar fajësinë procedura ka vazhduar me seancë kryesore.*

*Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se këtë marrëveshje e ka bërë në mënyrë vullnetare.*

*Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.*

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari i ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 KPRK-ës, veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2. të KPRK-ës dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par. 1. Nën par.1.4 të KPRK-ës.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari Z, K dhe mbrojtësja e saj janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të akuzuarit i shqiptohet dispozitivin II. me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind euro) dhe për veprën penale sikurse në dispozitivin III me dënim burgu prej 2.(dy) muajve burgim, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.05.2015 e deri me datë 08.06.2015 ashtu që pjesa e mbetur e dënimit me burgim prej 39 ditësh i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro e me zbatimin e dispozitave për dënimin unik për te dy veprat i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1.200 euro, të cilin gjobë i akuzuari do ta paguaj 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të i zëvendësohet me dënim burgu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, sa l përket të akuzuarve S.S dhe B. K si: raporti mbi këqyrjen në vendin e ngjarjes, foto dokumentacionit, dëshmia mbi konfiskimin e armës së zjarrtë, dhe mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjekoligjor lidhur me lëndimet e të akuzuarit-dëmtuarit A. T dhe vet pranimin e fajësisë nga ana e tyre, erdhi në përfundim se i akuzuari S. S se në kohë të pa vërtetuar me parë në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët, e ka sigurua dhe mbajte në pronësi armën të zjarrtë edhe atë një armë automatike me numër serik 680138, të cilën edhe e ka mbajte në kazinon “..” në Vsi dhe i akuzuari B. K. në kohën dhe vendin si në pikën II,III dhe IV të dispozitivit të aktakuzës gjatë kacafytjes me të pandehurin A.T, me dashje ka sulmuar fizikisht të njëjtin duke e goditë me grushte e shqelma në pjesë të ndryshme të trupit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenit 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit S. S dhe B.K.pa mëdyshje e kanë pranuar fajësinë, patën sjellje të mira në Gjykatë, se i kanë rregulluar raportet dhe nga ajo kohë nuk kanë pasur asnjë problem. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve të veprës penale nga se të njëjtit kanë vepruar me dashje si dhe rrezikshmërinë shoqërore. Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese e si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, të akuzuarve ju është shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, Afrim Shefkiu në fjalën përfundimtare e cila ka të bëjë me të akuzuarin A. T me provat e shtjelluara dhe pa mëdyshje është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet ne barre . Kjo gjendje faktike është vërtetuar me provat materiale edhe atë raporti mbi shikimin ne vendin e ngjarjes si dhe foto dokumentacionin, dëshmia mbi konfiskimin e armës te zjarrit e cila përfundimisht është gjetur tek i akuzuari Z. K . Po ashtu faktin se i akuzuari A. T e ka përdorur

armen vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitareve B. dhe Z. K për të cilët me pas është vendosur me marrëveshje për pranimin e fajësisë përkatësisht pranimin e fajësisë në seancë . Po ashtu nuk është kontestues fakti se arma e zjarrit ka qenë të banaku i kazinos “..i “ ku ka qenë edhe vet i akuzuari A, e cila armë ka qenë e të pandehurit S.S , e cila armë me vonë është sekuestruar nga i akuzuari Z. K . Po ashtu dëshmitari Dibran H i ka deklaruar se së bashku me këta persona ka shkuar tek kazino “Merkuri” , ashtu që duke pritur në automjet e ka pa Z.K.duke dal me një armë nga kazinoja , te cilën e kishte marrë nga kazino nga tani i akuzuari i vet ashtu si i kishte treguar Z. K . Se kacafytja ka ndodhur në kazino është vërtetuar nga dëshmitaret Sh.H dhe H.B., faktin se arma ka qenë tek banaku e vërteton edhe dëshmitari A. S sipas informacioneve të babait të tij S.S . Andaj propozojë që i akuzuari A.T.te shpallet fajtor dhe të dënohet sipas KPRK-së.

Dëshmitari D. H. deklaroi se ditën kritike se bashku me Z. , B dhe një shok të tyre të quajtur me pseudonimin “ “ kemi shkuar në Viti ashtu si me kanë thënë për ta marrur një borgj ashtu që në veturën time ka hyrë Z. Aty ka ora 01:00 pas mesnate në V. para një kazino kemi arritur me dy vetura dhe pasi që kemi arritur aty duke qenë se veturën time e ka vozitur Z, jemi ndalur aty dhe Z.ka zbritur nga vetura ashtu që me ka thënë unë të dal nga ana e vozitësit , derisa në kazino kanë hyrë Z dhe ai personi me pseudonimin “”. Nga vetura kam vërejt se diçka po ndodhe në kazino dhe me atë rast Z ka bere me shenje vëllaut të tij ashtu që vëllau të tij ashtu që edhe ai ka hyrë në kazino . Nga vetura kam vërejtur se në kazino kishte filluar përleshja dhe pas pak qaste nga kazino ka dalë Z .me vëllaun e tij dhe atë personin tjetër , ashtu që Z. ka ardhur në veturën time dhe me vete ka pasur një armë zjarri i cili ka thënë se armen ja ka marrë një personi brenda në kazino dhe me të njëjtën e kam goditur atë person , ashtu që me pas na ka ndalë policia dhe na kanë dërgu në stacionin policor.

Dëshmitari E.B. në mbrëmjen kritike deklaroi unë kam qenë në kazinon “e di që ka qenë diku pas mesnate dhe aty kanë qenë Sh dhe A .Derisa në ishim aty në kazino kanë hyrë dy persona me një sjellje jo të zakonshme dhe duke qenë duke punuar pastrues ju kam dalë përpara, ashtu që të njëjtit me kanë pyetur për A. S e unë ju tregova se A nuk është këtu ashtu që me këta dy persona kam dalur jashtë e me mua ka dalë jashtë edhe V . Derisa unë isha jashtë këta dy persona janë kthyer në kazino e me pas edhe unë kam hyrë brenda dhe e kam parë A të shtrirë dhe me pas këta persona shumë shpejt kanë dalë jashtë . Këta dy persona kur kanë hyrë brenda nuk kanë pasur asgjë në dorë e po ashtu edhe kur kanë dal nga kazino nuk e di se të njëjtit a kanë pas diçka në dorë pasi që kam qenë i stresuar nga ngjarja. Vlen të theksohet se unë në këtë kazino kam pas për obligim që të pastrojë si kundër edhe të kujdesem për aparatet por kam punuar edhe tek banaku . Gjate pastrimit të banakut kam parë lloj lloj sendesh por jo edhe armë , derisa mbrëmjen kritike në banak ka punuar edhe Sh .

Dëshmitari Sh. H deklaroi se në natën kritike kam qenë në lokalit – kazinon ngase aty e kam ndërruar vëllaun tim i cili ka qenë punëtor i asaj kazinoje pronar i se cilës ka qenë A. S . Në momentin kur kemi qenë ulur së bashku me E dhe V përballë banakut , derisa A në ato momente ka qenë në tualet, kanë ardhur dy persona për mua të pa njohur dhe e kanë kërkuar A.S– pronarin e kazinos . Nga kazinoja kanë dalë E, Valoni dhe ata dy persona e në ato qaste kam qenë i shqetësuar , derisa unë kam mbetur në kazino ashtu që kam hyrë në banak në mënyrë që

*të strehohem dhe më tutje nuk e di se qka ka ndodhur por kam dëgjuar zhurmë , bërtim dhe kur kam dal nga banaku ku isha strehuar e kam vërejtur se E e ka kapur A. për ta dërguar te mjeku . Se me qka është goditur A. nuk e di dhe se natën kritike unë nuk kam parë armë ne kazino .*

*Dëshmitari A. S deklaroi se pronari i kazinos ka qenë baba im S. S dhe sipas fjalëve te tij ka pasur edhe armë në kazino. Armen unë nuk e kam parë por ashtu siq e ka përshkruar babai im ka qenë arme e vjetër dhe jo funksionale . Natën kritike unë nuk kam qene ne kazino dhe se incidenti kishte ndodhur ne mes Zekë dhe B. K si dhe A i cili ka qenë prezent në kazino . Për incidentin mua përmes telefonit më ka informuar Sh. H dhe unë aty kam arritur pas incidentit kam shkuar ne kazino afër banakut kam vërejtur disa pika gjaku dhe se aty ishte krijuar rrëmujë , karrikat ishin te rrotulluara dhe per rastin me kishte njoftuar Sh se qka kishte ndodhur , derisa A e kam takuar tek ambulantë ne V. Siq më ka treguar babai arma ka qëndruar tek banaku derisa më pastaj ajo armë ka përfunduar në duart e Z apo B. K e gjithë kjo sipas punëtoreve te kazinos .*

*Gjykata beri shtjellimin e provave materiale dhe atë raportin mbi shikimin e ngjarjes, foto dokumentacionin i datë 18.05.2015, dëshminë mbi konfiskimin e armës së zjarrit dhe mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor lidhur me natyrën e lëndimit te shkaktuara te akuzuarit A. T*

*Gjykata pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veq e veq dhe te gjithave se bashku si në kuptim të Nenit 8 dhe 361 te KPPRK-së konstatoi këtë gjendje faktike se ditën kritike me datë 18.05.2015 rreth orës 01:00 ne Viti në kazinon “..” kishin shkuar Z. K , B. K dhe P.A kishin hyrë brenda dhe aty kishin qenë tani i akzuarit A. T .si kundër edhe dëshmitaret Sh. H , E. B , dhe një person me emrin V. dhe pasi qe ne kazino ishte krijuar rrëmujë dhe me atë rast edhe kishte ardhur deri te përleshja mes tyre ashtu që i akzuarit Z. nga kazinoja përkatësisht banaku kishte marrë armën e zjarrit të cilën e kishte lënë S. S (pronari i kazinos) dhe me të njëjtin e kishte goditur në kokë tani të akzuarin A.T.*

*Nga një gjendje e këtitillë e konstatuar faktike në veprimet e të akzuarit A. T nuk formohen elementet e veprës penale , përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga Neni 375 paragrafi 2 i KPRK-së e për te cilën i njëjti akuzohet . Nga dëshmia e dëshmitarit H. B dhe Sh. H nuk vërtetohet se me rastin kur të akzuarit B.K , P. A dhe Z.K kanë hyrë në kazino , i akzuarit A. T ta këtë përdorur armën e zjarrit . Ne fakt dëshmitaret H. B dhe Sh. H. deklarojnë se në atë moment A. T ka qenë në tualet dhe më pas nuk kanë parë se qka ka ndodhur . Edhe dëshmitari D. H ka deklaruar se me të dalë nga lokali – kazinoja Z.K ka dalë me armë në dore por se qka ka ndodhur brenda dhe ku e ka marrë të njëjtën nuk ka vërejtur . Edhe i akzuarit A. T kategorikisht e ka mohuar se ka pasur armen në dorë e aq me tepër ta këtë përdorur të njëjtën .*

*Andaj ne mungese te provave me te cilat do te dëshmohej se i akzuarit A. T. ta këtë kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe bazuar në nenin 364 paragrafi 1 pika 1.3 Gjykata të akzuarin A.T .e ka liruar nga përgjegjësia penale.*

*Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues , konfiskimin e armës se zjarrtë edhe atë pushkën automatike me nr. serik 680138 është bazuar në nenin 374 paragrafi 3 te KPRK-së.*



*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket te akuzuarve S. S, Z. K dhe B.K. është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket te akuzuarit A. T. është i bazuar në nenin 454 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr. 90 /2015 Me datë. 21.04.2017**

**Sekretarja juridike,**  
Naile Neziri

**Kryetari i trupit gjykues**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.